

VETERANI

GAZETË PERIODIKE

NR.07(385)

KORRIK 2020

ÇMIMI: 30 LEKË

Kryeredaktor: Halil RAMA ; Zv/Kryeredaktor: Sakip Cami

Email: veterani.obvl@yahoo.com / website: www.VETERANIOBVL.ORG

10 KORRIKU



10 KORRIKU Ngjarje kulmore në historinë e LANÇ

Rrahman PARLLAKU

FAQE 5

DOKUMENTARI



FADIL HOXHA, ARKITEKT I KOSOVËS SË LIRË

FAQE 4

DEKORIMI



Presidenti Meta çmon etnomuzikologun e shquar RAMADAN SOKOLI ME DEKORATËN “NDERI I KOMBIT”

FAQE 7

Kreu i shtetit vlerësoi mbrojtjen dhe mbajtjen gjallë të idealit atdhetar në drejtim të OBVL-së

KOLONEL MYFIT GUXHOLLIT I JEPET “DEKORATA E ARTË E SHQIPONJËS”

26 vjet OBVL – HISTORI SUKSESI

Halil Rama
Muharrem Gjoka

Në ceremoninë e dekorimit të kryetarit të OBVL-së, kolonel Ing.Myfit Guxhollit më 8 qershor 2020 në presidencë, Presidenti i Republikës, SHT Z.Illir Meta, ndër të tjera vlerësoi historinë e Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të Luftës së Popullit Shqiptar, si histori suksesi.

“Është kënaqësi e veçantë për mua t'i akordoj sot Kolonelit Myfit Guxhollit, “Dekoratën e Artë të Shqiponjës” për kontributin e çmuar si luftëtar i lirisë në radhët e Brigadës IV partizane, për rolin e tij në krijimin dhe konsolidimin e Ushtrisë Shqiptare dhe si themelues e drejtues i Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar. Më lejoni të shpreh sot konsideratën time më të lartë edhe për kontributin tuaj në mbrojtjen dhe promovimin e vlerave të Luftës së Lavdishme Antifashiste Nacional-Çlirimtare; për kontributin që ka dhënë dhe jep kjo organizatë në mbrojtjen e idealit të luftës për liri dhe transmetimit të brezave të rinj të vlerave, sakrificave dhe vetëmohimit të treguar gjatë epopesë së lavdishme të Luftës Nacional-Çlirimtare.

Ju, si bashkëthemelues i Organizatës të Bashkuar të Veteranëve të LANÇ të popullit shqiptar, me Dr.Ymer Dishnicën, Gjeneral Parllakun, Liri Belishovën, Edip Ohrin, Skënder Malindin e shumë të tjerë, në drejtimin e kësaj organizate, i keni bërë shërbimin më të mirë kombit dhe popullit shqiptar, duke nderuar sakrificën sublime, gjakun e dëshmorëve

VIDON NË FAQEN 6



Presidenti i Republikës, Sh.T.Z. Ilir Meta vlerësoi më 8 Qershor 2020 Kolonelin veteran Myfit Guxhollit me “Dekoratën e Artë të Shqiponjës” me motivacion: “Për veprimtarinë e shquar si luftëtar i lirisë në Luftën Antifashiste Nacional-Çlirimtare, si dhe për kontributin e tij të veçantë në krijimin dhe konsolidimin e artit të luftës dhe shkencës topografike ushtarake shqiptare. Në vlerësim të mbrojtjes dhe mbajtjes gjallë të idealit atdhetar në drejtim të Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të L.A.N.Ç.-it”

FAQE 3

21 VJET MË PARË



NATO-ja i dha fund një konflikti të tmerrshëm në Kosovë

Nga Bashkim Hisari FAQE 9

DEKLARATA

Ministeriali i Mbrojtjes, Xhaçka:

Do jemi në Kosovë,
Afganistan, Letoni

FAQE 7

HOMAZH

Lamtumirë Qerim Sula!

Nga Muharrem GJOKA

Nënkryetar i OBVL

FAQE 4

DITËLINDJA

BERNARD ZOTAJ, PRO- FESORI I HISTORISË USHTARAKE DHE TREVËS SË LABËRISË

Prof. Asoc. Dr. Zaho Golemi

FAQE 8

PROFIL

VIRON CINXO - MËSUESI I MREKULLUE- SHËM, VEPRA E TË CILIT MERITON VLERËSIM TË VEÇANTË

SHPENDI TOPOLLAJ

FAQE 10

LIBRI

Çfarë shkruan autori, si hyrje e librit
te tij “Vajza që sfidoi oficerin grek”?

QASJE REALE NË LIBRIN E QEMAL GEGOLLARIT

LILJANA MUÇA

Mirënjohe OBVL-së dhe
gazetës “VETERANI”

ZAIM SEFA

FAQE 11

SPECIALE

Kreu i shtetit vlerësoi mbrojtjen dhe mbajtjen KOLONEL MYFIT GUXHOLLIT I JEPET

HALIL RAMA

Presidenti i Republikës, Sh.T.Z. Ilir Meta vlerësoi më 8 Qershor 2020 Kolonelin veteran Myfit Guxholli me "Dekoratën e Artë të Shqiponjës" me motivacion: "Për veprimtarinë e shquar si luftëtar i lirisë në Luftën Antifashiste Nacional-Çlirimtare, si dhe për kontributin e tij të veçantë në krijimin dhe konsolidimin e artit të luftës dhe shkencës topografike ushtarake shqiptare. Në vlerësim të mbrojtjes dhe mbajtjes gjallë të idealit atdhetar në drejtim të Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të L.A.N.Ç.-it"

Në ceremoninë solemne të organizuar me këtë rast, ku merrnin pjesë anëtarët e Kryesisë së OBVL dhe familjarë e të afërm të kol.Guxhollit, duke iu drejtuar të pranishmëve Presidenti Meta u shpreh:

"Është kënaqësi e veçantë për mua t'i akordoj sot Kolonelit Myfit Guxholli, 'Dekoratën e Artë të Shqiponjës' për kontributin e çmuar si luftëtar i lirisë në radhët e Brigadës IV partizane, për rolin e tij në krijimin dhe konsolidimin e Ushtrisë Shqiptare dhe si themelues e drejtues i Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar.

Kolonel Guxholli, një ish-student i Liceut të Korçës, në momentet më të vështira dhe të errëta për vendin, i shtyrë nga atdhedashuria dhe një kontribut patriotik, u bashkua me armë në dorë në Luftën e lavdishme Nacional-Çlirimtare duke shërbyer edhe si kuadër i forumeve më të larta të Brigadës IV Sulmuese.

Si një ndër pedagogët më të shquar dhe Shef Katëdre në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve Tiranë, dhe tani si kryetar i Organizatës të Bashkuar të Veteranëve të LANÇ, kontributi dhe puna e Kolonelit Guxhollit në shërbim të vendit është e jashtëzakonshme dhe tejet e vyer.

Familja e nderuar Guxholli, Kolonel Myfiti, babai i tij Nevruzi së bashku me tre vëllezërit, Bexhetin, Qemalin dhe Arefiun, jo vetëm që u rreshtuan si partizanë në krah të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare, por shkrinë dhe dhuruan të gjithë pasurinë e familjes së tyre për Luftën.

Të gjithë së bashku ata luftuan përkrah Heroit të Popullit Reshit Çollaku me çetën partizane të Mokrës.

Kjo familje është shembulli më i shkëlqyer i patriotizmit dhe atdhedashurisë e cila na krenon të gjithëve dhe do mbetet e paharruar në historinë e vendit tonë dhe shembull frymëzimi për brezat e rinj.

Më lejoni të shpreh konsideratën time më të lartë edhe për kontributin tuaj në modernizimin dhe konsolidimin e Ushtrisë Shqiptare.

Është i njohur kontributi juaj si kryetopograf, shef seksioni dhe Nënkyetar i Degës së Topografisë pranë Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Shqiptare; si bashkautor, së bashku me specialistët e huaj në projektimin e zbatimit në praktikë, në terren të triangulacionit shtetëror (arshiva IGU/ 1954); si pedagog, shef cikli dhe shef i katedrës së topografisë, në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve.

Por sot, unë dua të vlerësoj edhe aktivitetin tuaj të pasur shkencor e pedagogjik, si autor i tekstit mësimor 'Gjeodezia' të përshtatur për studentët e specialitetit 'topograf' në Akademinë 'Skënderbej', por dhe për studentët të tjerë të specialiteteve të ndryshme që studiojnë gjeodezinë në këtë Akademi.

Këto janë një trashëgimi e çmuar që zënë vend nderi në analet e historikut të Forcave tona të Armatosura." – nënvizoi Presidenti Meta.

"Më lejoni të shpreh sot konsideratën time më të lartë edhe për kontributin tuaj në mbrojtjen dhe promovimin e vlerave të Luftës së Lavdishme Antifashiste Nacional-Çlirimtare; për kontributin që ka dhënë dhe jep kjo organizatë në mbrojtjen e idealit



KUSH ËSHTË KOLONEL ING.MYFIT GUXHOLLI

Ka lindur në Pogradec më 7 qershor 1930. Ishte vetëm 9 vjeç, kur iu bashkua lëvizjes së rinisë pogradecare që kërkonte armë për të shkuar në Durrës që të luftonin kundër pushtimit fashist të vendit.

Po ashtu, pas një viti, nga urrejtja për inxhinierin italian që ishte major i Simit dhe që punonte në minierën e kromit "Guri i Kuq", e qëllon atë më një gur në bel. Myfiti i shpëtoi arrestimit pasi e fshehu rinia pogradecare ndërmjet protestuesve. Shkollën fillore e kreu në vendlindje dhe më pas studioi për dy vjet në Liceun e Korçës. Myfiti rrjedh nga një familje e pasur atdhetare dhe patriotike. Gjatë okupimit nazifashist të vendit, familja e tij u përfshi e tëra në luftën kundër okupatorit, madje babai i tij u burgos për aktivitet antifashist.

Myfiti, megjithëse në moshë fare i ri, që në shkurt 1944 u rreshtua në radhët e ushtrisë partizane në Brigadën e IV-të Sulmuese, si kuadër i kësaj brigade. Mbas çlirimit të vendit nga pushtuesit nazifashist, me hapjen e Shkollës "Skënderbej" mbaron me rezultate të mira dy vite mësimore të kësaj shkolle dhe më pas mbaroi Shkollën e Lartë të Topografisë Ushtarake në Leningrad (ish Bashkimi Sovjetik). Pas diplomimit u emërua në Degën e Topografisë në Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë. Krahas detyrës së tij funksionale ai vazhdoi studimet dhe në Fakultetin e Inxhinierisë të Universitetit të Tiranës, në mbarim të të cilave u titullua "Inxhinier topograf".

Ai ka kryer detyra të rëndësishme në Ushtri. Pasi u gradua N/toger u emërua kryetopograf, më vonë shef seksioni dhe N/kryetar Dege të Topografisë pranë Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Shqiptare. Gjatë viteve 1952-1961 ka marrë pjesë në organizimin, projektimin dhe zbatimin në terren të të gjitha punimeve topogeo-dezike për sigurimin topografik të Ushtrisë në të gjithë territorin e Shqipërisë. Është bashkautor, së bashku me specialistët e huaj në projektimin e zbatimit në praktikë në terren të triangulacionit shtetëror (arshiva IGU/ 1954).

Nga viti 1961 deri në 1985 shërbeu në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve (sot Akademia "Skënderbej") si pedagog, shef cikli dhe shef i katedrës së topografisë, me gradë major. Gjatë kohës së mësimdhënies dhe drejtimit të katedrës në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve Ing. Myfit Guxholli ka një aktivitet të pasur shkencor e pedagogjik.

të luftës për liri dhe transmetimit të brezave të rinj të vlerave, sakrificave dhe vetëmohimit të treguar gjatë epopesë së lavdishme të Luftës Nacional-Çlirimtare.



Ju, si bashkëthemelues i Organizatës të Bashkuar të Veteranëve të LANÇ të popullit shqiptar, me Dr.Ymer Dishnicën, Gjeneral Parllakun, Liri Belishovën, Edip Ohri, Skënder Malindin e shumë të tjerë, në drejtimin e kësaj organizate, i keni bërë shërbimin më të mirë kombit dhe popullit shqiptar, duke nderuar sakrificën sublime, gjakun e dëshmorëve, heroizmin e luftës partizane, që ishte dhe mbetet lufta më e madhe patriotike që ka zhvilluar populli shqiptar për lirinë e Atdheut.

Kjo luftë e lavdishme që realizoi çlirimin e atdheut nga okupatori nazifashist dhe e shpëtoi vendin tonë nga planet për ndarjen, duke e radhitur Shqipërinë në anën e Aleancës së madhe të popujve kundër Aksit të së keqes, është padyshim një meritë për Shqipërinë europiane, që sot është anëtare e NATO-s dhe aspirante për anëtare të BE-së, sepse në themel të Europës së Bashkuar qëndrojnë vlerat demokratike dhe çlirimtare të Luftës së Dytë Botërore.

Më lejoni që me këtë rast t'ju uroj përzemërsisht

SPECIALE

gjallë të idealit atdhetar në drejtim të OBVL-së “DEKORATA E ARTË E SHQIPONJËS”



në pronësi të Nevruz Pasho Guxhollit, transportonte misër e grurë, çimento, dërrasa e materiale të tjera ndërtimi. Kur sapo ishte fuqizuar ekonomisht, Familja Guxholli, më 1930 kishte blerë në Greqi një fabrikë mielli, e cila siguronte miell për qytetin e rrethit e Pogradecit, por edhe për Korçën, Bilishtin e Ersekën.

Në koherencë me realitetin e atyre viteve, Nevruz Pasho Guxholli ishte aksioner edhe në shoqëri të private të sjelljes së dritës elektrike në qytetin e Pogradecit. Dhe jo vetëm kaq, por si një nga biznesmenët e njohur, krahas fuqizimit ekonomik të familjes, kishte filluar të merrej edhe me politikën provinciale të kohës. Ai ishte marrë me tregti e njëkohësisht kishte qenë edhe këshilltar në administratën vendore qysh në vitin 1923. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, kjo familje, si dhe gjithë fisi Guxholli, e kundërshtuan pushtimin e atdheut. Për veprimtari patriotike dhe për qëndrimin e tij kundër okupatorit fashist, Nevruzi burgoset në Korçë në vitin 1943.

Pas kapitullimit të Italisë fashiste arratiset nga burgu së bashku me shokët e tij dhe me armë në dorë i bashkëngjitet Lëvizjes Nacionalçlirimtare, ndërkohë që djemtë e tij, Bexheti, Qemali, Arefiu dhe Myfiti, si partizanë u rreshtuan në krah të Ushtrisë Nacionalçlirimtare. U burgosën si antifashistë tre vëllezërit, të cilët kishin lënë shkollën dhe ishin lidhur me Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare. Në Luftën Antifashiste, qysh në fillimet e saj, u përfshi e gjithë familja Guxholli, ndërsa me armë në dorë luftuan tre djemtë e kësaj familjeje.

Është i njohur aktiviteti i tyre: Bexheti, që në maj 1943, me çetën e Mokrës e batalionin “Reshit Çollaku”; Myfiti, si kuadër në Brigadën e IV-t S; Qemali, në qytet me grupet antifashiste dhe Arefiu i vogël, korrier me partizanët e Mokrës. Por gjithsesi, edhe kjo familje që shkriu pasurinë për luftën, do të përballej me represionin e pushtetit komunist. Pas çlirimit, Nevruzi ishte anëtar i të parit këshill vendor në Pogradec, ndërkohë që prej vitit 1946 -1947, burgoset për mospagimin e tatimit-fitimit. Do të rehabilitoheshin disi më vonë, kur falë intelektit, zgjuarsisë dhe përkushtimit ndaj atdheut, do të dilnin katër oficerë nga kjo familje: Bexheti e djali, Iliri, Myfiti e djali, Artani.


VEPRIMTARIA KRIJUESE E SHKENCORE E ING.MYFIT GUXHOLLIT

Ka përgatitur cikle të plota të leksioneve ushtarake në gjeodezinë e lartë, në gjeodezinë inxhinierike si dhe leksionet e gjeografisë ushtarake për Akademinë e Mbrojtjes dhe atë “Skënderbej”. Në vitin 1986 boton tekstin mësimor “Gjeodezia” të përshtatur për studentët e specialitetit topograf në Akademinë “Skënderbej”, por dhe për studentët të tjerë të specialiteteve të ndryshme që studiojnë në këtë Akademi gjeodezinë, si xhenio etj. Po ashtu, ai është bashkautor i hartave të territorit shqiptar të shkallëve 1 : 26000 – 1: 50000 (projektet në IGU Tiranë).

Ing. Myfit Guxholli është autor i dhjetëra artikujve shkencorë, ndërkohë që ka përgatitur

Rregullore të ndryshme dhe ka mbajtur referate e kumtesa cilësore në disa simpoziume e konferenca shkencore. Duke vlerësuar aktivitetin e pasur të tij në vitin 1973 Katedra e Topografisë e Akademisë Ushtarake “Skënderbej” propozoi që Ing. Myfit Guxhollit t’i jepej titulli “docent”, por pas ngjarjeve të atyre viteve të “stuhishme” propozimi i asaj katedre u pezullua.

Me ndryshimin e sistemit komunist, Myfiti familjarisht përfshihet në proceset demokratike duke dhënë një kontribut të shquar në fitoren e demokracisë. Ai ka qenë një nga organizatorët e krijimit të Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të Luftës (OBVL), së bashku me Dr.Ymer Dishnicën, gjeneral Rrahman Parllakun, Liri Belishovën, Edip Ohrin, Skënder Malindin e dhjetra personalitete të tjera të LANÇ e të Ushtrisë Shqiptare. Për kontributin e tij kol.ing.Guxholli është zgjedhur zv/kryetar i kësaj organizate që nga themelimi i saj para 26 vitesh dhe që nga data 1 Nëntor 2019 është kryetar i saj, duke punuar me përkushtim për edukimin patriotik të brezave. Për të gjitha këto merita kryesia e OBVL-së i ka propozuar edhe Këshillit të Bashkisë që ta shpallë atë “Qytetar Nderi të Pogradecit”.



ditëlindjen tuaj të ‘90-të! Ju uroj një jetë të gjatë, me shëndet të plotë, dhe me këtë vitalitet e shpirt krijues që keni sot.

Ju jemi gjithmonë mirënjohës për kontributin tuaj shumë të çmuar për Shqipërinë, për ushtrinë tonë dhe kombin shqiptar!”, – vuri në dukje Presidenti i Republikës para se t’i dorëzonte dekoratën e lartë luftëtarit të lirisë, veteranit të LANÇ-it, Kolonelit Myfit Guxholli.

Duke e falenderuar Presidentin Meta për vlerësimin, Kolonel Myfit Guxholli në fjalën e Tij përshëndese theksoi ndër të tjera se “kjo Dekorata e lartë i takon të gjithë atij brezi që e nisi jetën nga lufta për të kontribuar për çlirimin e Atdheut dhe përparimin e tij”.

FAMILJA GUXHOLLI, SI UA MOHOI PUSHTETI KOMUNIST KONTRIBUTIN NË LUFTË

Kolonel Ing.Myfit Guxholli i përket familjes së njohur pogradecare që shkriu pasurinë e saj për luftën Antiofashiste Nacionalçlirimtare.

Në vitet 1920-1940, pogradecarët lundronin përmes liqenit për në Ohër e Strugë dhe merrnin mallra që andej me tragetin “Ylli i bardhë”. Trageti,

OBVL Durrës uron kolonel Guxhollin në 90-vjetorin e ditëlindjes

Kryetari i OBVL, Dega Durrës Z.Genci Ballanca, i shpreh urimet më të përzemërta kolonel Myfit Guxhollit me rastin e 90-vjetorit të ditëlindjes së tij. Në mesazhin e urimit ai vlerëson kontributin e kol.Myfit Guxhollit si partizan me armë në dorë gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare sidhe për organizimin e konsolidimin e ushtrisë shqiptare. Një vlerësim të veçantë z.Ballanca shpreh për rolin e kol. Guxhollit në krijimin, organizimin dhe drejtimin e OBVL-së, si ish-nënkryetar dhe tani si kryetar i kësaj organizate.

Me rastin e dekorimit nga Presidenti i Republikës Z.Illir Meta me “Dekoratën e Artë të Shqiponjës” kryetari i OBVL, kol.Myfit Guxholli ka marrë mesazhe urimi nga nënkryetari i OVLANÇ të Kosovës Z.Bashkim Hisari, nga kryetari i OBVL, Dega Shkodër, kol.Ali Demushi, nga studjuesi Xhemal Meçi - “Mjeshtër i Madh”, si dhe nga qindra nga veteranë e pasardhës nga të gjitha rrethet e vendit.

DOKUMENTARI



FADIL HOXHA- ARKITEKT I KOSOVËS SË LIRË

Filmi është një narrativë dokumentare me efekte letrarizuese ku dimensionimi i liderit Kosovar Fadil Hoxha jepet në diskursin e tij politik e patriotik, në mbrojtje të të drejtave dhe lirive të popullit shqiptar në Kosovë si dhe rolin bashkëpunues në politikëbërje në mbrojtje të kauzës shqiptare.

Skenari dhe materialet filmike, intervistat me personalitetet më të shquara akademike në Shqipëri dhe Kosovë jepen në film në mënyrë etetiko-profesionale me një nivel të lartë, duke përciellë vlera dhe mesazhe aktuale në dobi të përparimit të shqiptarëve.

Në vlerësimet që bëjnë figurat me të shquara kombëtare akademike, historike dhe publicistike si Akademik Rexhep Qosja, Jusuf Bajraktari, Paskal Milo, Nevila Nika, publicistët Veton Surroi, Akif Bajrami etj... përcaktojnë dhe ridimensionojnë figurën dhe rolin e Fadil Hoxhës në historinë e Kosovës gjatë Luftës së Dytë botërore deri në Luftën e UÇK-së, sidomoas roli i tij vendimtar për Kushtetutën e vitit 1974 që përcaktoi Kosovën krahinë autonome, kufijte e së cilës shërbyen për shtetin e sotëm të pavarur të Republikës së Kosovës.

Një vend të rëndësishëm në film zë roli i Fadil Hoxhës në tejkalimin e

prapambetjes kulturoro-arsimore të shqiptarëve në ish-Jugosllavi, arritjet në fushën e të drejtave politike në kuadrin e autonomisë, lirisë dhe të drejtave politike e kombëtare, dhe arritjet në Kushtetutën e 1974, përpjekjet në Konferencën e Bujanit për bashkimin kombëtar të shqiptarëve etj...

Filmi paraqet formimin, frymën, qëndrimet, vlerat dhe arritjet e Fadil Hoxhës si udhëheqësi më jetëgjatë i Kosovës, duke dhënë në gjuhë filmike, momentet dhe pasazhet më

domethënëse që shërbejnë për plotësimin e shembëlltyrës së Fadil Hoxhës, si protagonist kryesor.

Teksti i skenarit ruan koherencën kontekstuale, mbështetet në inserte ndëraktive që ndërthuren në formë kujtimesh dhënë në mënyrë estetike.

Në realizimin e filmit është marrë parasysh asistenca dhe mirëkuptimi i Kryesisë së Shoqatës Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të Kosovës e cila është producenti i këtij filmi.



Lamtumirë Qerim Sula!

Nga Muharrem GJOKA

Nënkryetar i OBVL

Bilbilin e këngës popullore dibrane Qerim Sula e përcollëm për në botën e përtejme ashtu siç na e kishte lënë amanet: në Zall Dardhë, vendlindjen e tij, tek varret e të parëve. Qe vërtetë një ndarje e trishtë me mikun më të ngushtë, shokun e fëmijërisë e të gjithë jetës, Qerim Sula, të cilin me meritë Presidenti i Republikës e ka dekoruar me Titullin “Mjeshtër i Madh”.

Miq të e përbashkët, Latif Miha e Defrim Methasani që treguan përkujdesje maksimale e interesim të vazhdueshëm tek mjekët kompetentë për t’ia zgjatur atij jetën, ishin me mua e të afërmit e tij në përcjelljen e arkivolit me trupin e pajetë të Qerimit nga Tirana për në Zall Dardhë, edhe atë të dielë të trishtë të 31 Majit 2020. E përcollëm me të gjitha nderimet siç e meritonte, madje edhe nën ritmin e këngës së tij hymn “Na k’nojn pushkët nëpër kulla”, siç na e kishte lënë amanet për ditën e ceremonisë së tij mortore. Ishte një përcjellje dinjitoze e njeriut legjendë, vdekjen e të cilit, edhe Presidenti i Republikës SHT Z.Illir Meta e konsideroi një lajm trishtues për të gjithë vendin. Për vdekjen e mjeshtrit të këngës dibrane, një prej zërave më të spikatur të muzikës popullore shqiptare, këngët e të cilit do të kumbojnë përjetë në zemrat tona, si frymëzim për mbrojtjen e lirisë dhe sovranitetit të Atdheut, kreu i shtetit shqiptar Ilir Meta është shprehur: “Ndarja nga jeta e rapsodit të shquar dibran dhe njërit prej zërave të spikatur të muzikës popullore shqiptare, Qerim Sula është një lajm trishtues. Këngët epike për trimërinë e dibranëve dhe hymnet e krenarisë kombëtare të interpretuara mjeshtërisht prej Tij



do kumbojnë përjetë në zemrat tona, si frymëzim për mbrojtjen e lirisë dhe sovranitetit të Atdheut. Ngushëllime familjes Sula, ardashësve dhe të gjithë komunitetit dibran! Lamtumirë Mjeshtër!

...Një lamtumirë që ia dhanë atij me lotë në sy e dhimbje të thellë në zemër, qindra e mijëra shokë e miq nga Zall Dardha, Dibra e gjithë Shqipëria.... Jo vetëm ata që ishin të pranishëm në ceremoninë mortore, por edhe ata që shprehën ngushëllimet nëpër rrjetet sociale, brenda vendit e nga hapësira mbarëshqiptare në botë.

Qerim Sulën nuk e kemi më fizikisht mes nesh, por ai rron e do të rrojë në zemrat tona. Ashtu si

edhe kënga e tij që do të jehojë e kumbojë fuqishëm në dasma e gëzime familjare, si dhe në veprimtari të ndryshme promovuese.

Qerim Sula e humbi betejën me jetën pas një sëmundje të rëndë. Ai mban titullin “Mjeshtër i Madh”. Këngëtari i këngëve epike dhe traditës u nda nga jeta në moshën 69-vjeçare. Amaneti i tij që “Më varrosni në Zall-Dardhë, aty ku linda”, dhe tani ai prehet i qetë pikërisht pranë të parëve të tij.

Qerim Sula lindi në 12 prill 1951. Edhe pse mbaroi shkollën mekanike, ai ishte i dashuruar dhe i përkushtuar për muzikën, ndaj që në moshë të re u aktivizua me grupet amatore të Zall Dardhës, ndërsa në vitin 1967 me ansamblin “Dibra”. Më 1978 bën prezantimin e parë në Festivalin Folklorik të Gjirokastrës me këngën epike “Na k’nojn pushkët në kulla”, ku u vlerësua me çmim të parë për interpretimin e tij. Ka marrë pjesë në të gjitha Festalet Folklorike deri në vitin 2000.

Ai është aktivizuar në mjaft trupa e ansamble, si dhe ka qenë pjesëtar i Estradës Profesionaliste të Peshkopisë. Ka kënduar në shumë skena të vendit por edhe jashtë shtetit, si në Gjermani, Austri, Turqi, Belgjikë, etj.

Në vitin 1981 ishte në Kosovë me ansamblin “Kukësi i ri”. Në repertorin e tij ka një numër të madh këngësh epike, duke qenë nga këngëtarët më të suksesshëm të trevës së Veriut, i vlerësuar me mjaft çmime e diploma të ndryshme, në aktivitete kombëtare. Ka realizuar dy albume me këngët më voluminoze dibrane.

**Lamtumirë kushëriri im më i mirë!
U prefsh në paqe. Parajsa qoftë vendbanimi yt
i përjetshëm!**

10 KORRIKU

77 vjet më parë u krijua Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë NÇI

Ngjarje kulmore në historinë e LANÇ

RRAHMAN PARLLAKU

Viti 1943 shënoi rritje në përmasa të mëdha të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Në gjithë vendin ishin krijuar njësite guerile, çeta e batalione partizane. Luftimet zhvilloheshin jo të veçuara nga çetat e batalionet, por të përbashkëta e të koordinuara brenda qarkut.

Po në korrik të atij viti, filluan të zhvilloheshin veprime luftarake të përbashkëta edhe në mes qarqeve të ndryshme, siç ishin luftimet e Përmetit, ku morën pjesë forcat e Gjirokastrës, Korçës e Beratit. Shtimi i radhëve të Ushtrisë partizane, çlirimi i krahinave të ndryshme, jehona e luftës së përhapur në të gjithë vendin u ndien edhe në botën e jashtme dhe u vlerësuan nga Fuqitë e Mëdha të Aleancës Antifashiste.

Ata e njohën Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar, dërguan përfaqësuesit e tyre pranë Shtabit të Përgjithshëm, Zonës së Parë Operative, qarqeve e njësive që ta ndiqnin nga afër e ta ndihmonin atë. Ky nivel i ri i Luftës Antifashiste kërkonte që Ushtria të kishte një strukturë të re organizative, të njëjtë si për repartet sulmuese dhe territoriale, ashtu edhe për krijimin e njësive taktiko-operative për veprime në të gjithë vendin. Rritja sasimore dhe cilësore e ushtrisë kërkonte drejtim unik dhe bashkërendim të veprimeve luftarake në shkallë vendi.

HAP CILËSOR NË DREJTIM TË LUFTIMEVE

Në këtë shkrim nuk kam marr për-sipër të flas gjatë për fillnisjen dhe vazhdimësinë e Ushtrisë Kombëtare Shqiptare, pasi kjo u takon historianëve, por të përkujtoj e të them diçka për një nga datat më të rëndësishme në historinë e Ushtrisë Shqiptare, atë të krijimit të Ushtrisë Antifashiste Nacionalçlirimtare. Gjykoj se kjo datë do të zërë vendin e merituar në analet e historisë së kombit tonë. Krijimi i Shtabit të Përgjithshëm, 77 vjet më parë, më 10 Korrik 1943, me vendim të Këshillit të Përgjithshëm Antifashist Nacionalçlirimtar e zgjidhi problemin e drejtimit të përqendruar të Ushtrisë. Kjo do të përkujtohet si dita e themelimit të Ushtrisë Antifashiste Nacionalçlirimtare. Në përbërjen e Shtabit të Përgjithshëm u emëruan figurat më të afirmuara udhëheqëse të Luftës. Komandant i Shtabit u caktua Spiro Moisiu, që ishte jo vetëm luftëtar i afirmuar, por edhe i pajisur me kulturë ushtarake. Me krijimin e Shtabit të Përgjithshëm u bë një hap cilësor në drejtim të luftimeve, u bë kalimi nga një ushtri partizane me bazë rajonale në një ushtri mbarëkombëtare me strukturë organizative, që t'i përgjigjej jo vetëm stadi të arritur, por edhe perspektivës së kalimit në ushtri të rregullt. Shtabi i Përgjithshëm mori masa të menjëhershme për organizimin e strukturave ushtarake si të forcave operative, territoriale dhe të administratës ushtarake. Në forcat operative hynin brigadat sulmuese, që ishin të destinuara të vepronin në gjithë hapësirën e territorit të vendit dhe forcat territoriale, që varehin nga komandat e qarqeve.

Në krahinat e çliruara, qarqet kishin krijuar organet administrative ushtarake, komandat e vendit në krahina, spitale, depo furnizimi etj.. Ky organizim ushtarak e justifikoi plotësisht veten në realizimin e detyrave luftarake nga njësitë e repartet, ku u kombinua mirë drejtimi nga Shtabi i Përgjithshëm me iniciativën e gjerë në veprimet luftarake nga vetë komandat e njësive e reparteve, komandat e qarqeve dhe të Zonës së Parë Operative që përfshinte qarqet Vlorë dhe Gjirokastrë. Kjo iniciativë ishte mëse e domosdoshme, pasi luftimet zhvilloheshin pa front të rregullt, mjete teknike të ndërlidhjes e drejtimit



mungonin, kryesisht, komunikimi me Shtabin e Përgjithshëm me ndërprerje të gjatë kohe.

PARTIZANËT PËRBALLUAN VËSHTIRËSI MBINJERËZORE

Shtabi i Përgjithshëm, me gjithë kushtet tepër të vështira në të cilat vepronte dhe mungesën që kishte për ushtarakë të mirëfilltë, përgatiti e dërgoi disa udhëzime normative për rregullimin e jetës në reparte, drejtimin e luftimit, rregullin e disiplinës ushtarake, të kombinimit të disiplinës së ndërgjegjshme në zbatimin e detyrave etj.. Është me vend të theksojmë se kjo ishte disiplinë shembullore, e vetëpranuar jo vetëm në marrëdhëniet mes luftëtarëve, por edhe me popullin dhe nuk e thyenin atë qoftë edhe kur duhej dhënë jeta.

Masat organizative dhe ushtarake që mori Shtabi i Përgjithshëm, përgatitja dhe edukimi i forcave partizane me ndjenjën e lartë të përgjegjësisë për çlirimin e vendit nga zaptuesit, i bënë repartet dhe njësitë e Ushtrisë Antifashiste Nacionalçlirimtare të përballojnë vështirësi, do të thosha mbinjerëzore.

Vetëm ai që ka përballuar vështirësitë e Operacionit Nazist të Dimrit 1943-'44 e di fort mirë këtë, të tjerët vështirë ta kuptojnë. Kjo përgatitje shpirtërore dhe vendosmëri për kalimin e vështirësive bëri që repartet e njësitë e dështuara rëndë ta marrin shumë shpejt veten në pranverën e vitit 1944 e të hidhen në sulm, që e befaso i keqas armikun. Këtë e kanë shprehur edhe përfaqësuesit e aleatëve në shkrimet e kujtimet e tyre, shumë prej të cilëve kanë ardhur edhe në Shqipëri.

NDRYSHIMET ORGANIZATIVE ISHIN TË KARAKTERIT OPERATIVO-STRATEGJIK

Shtimi i shpejtë i reparteve e njësive të Ushtrisë Antifashiste Naciona-

lçlirimtare, sidomos krijimi i brigadave sulmuese, veprimet e tyre luftarake në hapësira të mëdha të territorit, çlirimi i shumë krahinave të vendit, i mbylli nazistët në qytetet dhe në ruajtjen e disa pikave bregdetare e të rrugëve kryesore. Në këto kushte, Shtabi i Përgjithshëm mori masa për ndryshime organizative e të drejtimit të njësive që ishin të karakterit operativ-strategjik, ndryshime në zhvillimin e veprimeve luftarake, kalimin nga luftimet pa front të rregullt në kryerjen e luftimeve dhe operacioneve në front të gjerë.

Këto masa të parashikuara nga Shtabi i Përgjithshëm, u aprovuan në Kongresin Antifashist të Përmetit më 24 Maj 1944. Kështu u krijua Komanda e Përgjithshme, u vendosën gradat ushtarake, u krijuan njësitë operative strategjike. Të gjitha këto masa i jepnin Ushtrisë Antifashiste Nacionalçlirimtare karakterin e një ushtrie të rregullt, me perspektivë për kalimin në mësymjen e përgjithshme për çlirimin e plotë të vendit.

Komandant i Përgjithshëm i saj u caktua Enver Hoxha, i cili përqendroi të tjerat si atë të Sekretarit të Parë të Partisë, atë të Kryeministrit, të ministrit të Jashtëm etj.. Por siç dihet, ai nuk ka pasur as njohuritë minimale si ushtarak, prandaj detyrën e drejtimit të Ushtrisë deri në çlirimin e vendit e kreu Shtabi i Përgjithshëm, i përforcuar me kuadro të përgatitura, si dhe komandat e njësive e të reparteve. Nazistët e bashkëpunëtorët e tyre bënë tentativën e fundit në shkallë të madhe me Operacionin e Qershorit '44, duke grumbulluar forca të shumta për të goditur, dëmtuar e penguar Ushtrinë Antifashiste Nacionalçlirimtare në zhvillimin e forcimin e mëtejshëm të saj dhe luftën për çlirimin e vendit. Por hovi që kish marrë lufta, shtimi e

• *Krijimi i Shtabit të Përgjithshëm, 77 vjet më parë, më 10 Korrik 1943, me vendim të Këshillit të Përgjithshëm Antifashist Nacionalçlirimtar e zgjidhi problemin e drejtimit të përqendruar të Ushtrisë. Kjo do të përkujtohet si dita e themelimit të Ushtrisë Antifashiste Nacionalçlirimtare. Në përbërjen e Shtabit të Përgjithshëm u emëruan figurat më të afirmuara udhëheqëse të Luftës. Komandant i Shtabit u caktua Spiro Moisiu, që ishte jo vetëm luftëtar i afirmuar, por edhe i pajisur me kulturë ushtarake*



forcimi i vazhdueshëm i Ushtrisë Antifashiste Nacionalçlirimtare e thyen shpejt këtë përpjekje të dëshpëruar të armikut në shkallë vendi. Mbas kësaj, Ushtria Antifashiste Nacionalçlirimtare kaloi në mësymjen e përgjithshme, gjë që çoi në çlirimin e vendit nga pushtuesi.

Ushtria Nacionalçlirimtare shqiptare luajti rol të rëndësishëm në Kosovë dhe në krahina të tjera të ish-Jugosllavisë. U zbatuan me vendosmëri detyrat e marra nga Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë NÇI, për të ndihmuar popullin e Kosovës për çlirimin e tij, duke ndikuar në rritjen e pjesëmarrjes të sa më shumë kosovarëve në këtë luftë të madhe, për të pasur të drejtën e vetëvendosjes pas mbarimit të saj. Po ashtu, u zbatua detyra për ngritjen e pushtetit, pasi shumicën në këshilla e kishin shqiptarët. Brigadat partizane të Ushtrisë Nacionalçlirimtare shqiptare dhanë një kontribut të veçantë në Kosovë. Në zbatim të detyrave të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare shqiptare, brigadat dhe formacionet tjera partizane të kësaj ushtrie u angazhuan për të penguar dhe dëmtuar forcat gjermane në tërheqje, me qëllim që ato të mos shkonin të organizuara në Frontin Perëndimor kundër Aleatëve. Në këtë aspekt, është e njohur lufta e dy divizioneve tona në ish-Jugosllavi, për të ndihmuar në çlirimin e popujve jugosllavë, divizione këto që vazhduan të pengonin e dëmtonin forcat gjermane që tërhiqeshin për në Frontin e Perëndimit, duke dhënë kontributin tonë në kuadrin e koalicionit botëror antifashist.

* Marrë nga Libri "Një shekull në memorie" i gjeneral-lejtënant Rrahman Parllaku - Hero i Popullit dhe Nderi i Kombit - Ish-kryetar i OBVL

REPORTAZH

Organizata e Bashkuar e Veteranëve të LANÇ të popullit shqiptar është anëtare e Federatës Europiane e Botërore të Veteranëve

26 vjet OBVL – HISTORI SUKSESI

(vijon nga fq.1)

, heroizmin e luftës partizane, që ishte dhe mbetet lufta më e madhe patriotike që ka zhvilluar populli shqiptar për lirinë e At-dheut.

Kjo luftë e lavdishme që realizoi çlirimin e atdheut nga okupatori nazifashist dhe e shpëtoi vendin tonë nga planet për ndarjen, duke e radhitur Shqipërinë në anën e Aleancës së madhe të popujve kundër Aksit të së keqes, është padyshim një meritë për Shqipërinë europiane, që sot është anëtare e NATO-s dhe aspirante për anëtare të BE-së, sepse në themel të Europës së Bashkuar qëndrojnë vlerat demokratike dhe çlirimtare të Luftës së Dytë Botërore, -tha ndër të tjera Presidenti Meta.

Më 18 korrik mbushen 26 vjet nga krijimi i Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të Luftës së Popullit Shqiptar.

OBVL është një organizatë shoqërore atdhetare. Ajo u formua që të vlerësojë realisht historinë e luftës së lavdishme Nacional Çlirimtare, që të shmangë shtrembërimet e periudhës së regjimit diktatorial të E.Hoxhës, mohimet dhe politizimet e bëra nga historiografë të atij regjimi, por edhe me qëllim të caktuar nga individë që kërkonin lavdi dhe pushtet të pamerituar. Në kurtin e tyre ranë me dëshirë dhe me servilizëm historianë të ndryshëm që e shtrembëruan historinë për karriket e tyre.

Për të penguar këtë qasje negative, këtë tendencë të dëmshme si për demokracinë ashtu edhe për historinë e popullit shqiptar me nismën e një grupi prej 64 personalitetesh, gjeneralësh dhe luftëtarësh, figura politike të respektuara, por fatkeqësiht të dënuar nga regjimi komunist, para 26 vitesh u formua Organizata e Bashkuar e Veteranëve të Luftës së Popullit Shqiptar (OBVL).

Në këtë grup bënë pjesë figura politike të respektuara që kishin qenë drejtues të repartëve partizane e ministra, siç ishin: Kiço Ngjela, Manol Konomi, Fadil Paçami, Maqo Çomo, Sadik Bekteshi (gjeneral lejtnant-Hero i Popullit), Muhamet Prodani (gjeneral lejtnant-Hero i Popullit), gjeneral-majorët: Nexhip Vinçani dhe Ernest Jakova; luftëtarët e shquara, drejtues në luftë e aktivistë të OBVL: Selfixhe Broja(Ciu), Zenepe Golemi (Ashiku), Liri Belishova, Vera Ngjela (Pojani), Mine Doraci e disa të tjera, por Organizata e Bashkuar



e Veteranëve të LANÇ të popullit shqiptar është anëtare e Federatës Europiane e Botërore të veteranëve 26 vjet OBVL fatkeqësisht të dënuara nga regjimi diktatorial i Enver Hoxhës.

Kuvendi i parë themelues i Organizatës të Bashkuar të Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare (OBVL) në krye të saj zgjodhi personalitetin e shquar Dr. Ymer Dishnicën.

OBVL i bëri thirrje Komitetit Kombëtar të Veranëve të Luftës Nacional Çlirimtare për bashkim, por me kushtin e zgjedhjeve të reja në bazë dhe në qendër të veteranëve, të ndryshimit të statutit dhe programit, të rishikimit të historisë së LANÇ, të dënimit të krimeve të komunizmit. Këto kërkesa u refuzuan nga Komiteti Kombëtar i Veranëve të Luftës Nacional Çlirimtare.

Menjëherë pas zgjedhjes, Kryesia e OBVL ju vu punës për përgatitjen e projektligjeve e që do të vinin në vendin e merituar figurën e respektuar të veteranit të LANÇ dhe propozimin e miratimit të tyre në parlament, duke e vënë kështu veprimtarinë e saj mbi baza ligjore në interes të veteranëve, invalidëve të luftës dhe familjeve të dëshmorëve. Në këtë mënyrë u ligjësua figura e respektuar e veteranit të LANÇ.

Organizata e Bashkuar e Veteranëve

të LANÇ u shtri rrufeshëm në gjithë Shqipërinë. U krijuan dhe u konsoliduan degët tona në rrethet si vijon: Në Tiranë me kryetar z.Muhamar Spahiu, Korçë, me kryetar Z.Haxhi Runi, Elbasan me kryetar z.Sami Vinçani, Durrës, me kryetar z.Idriz Hoxha, Shkodër me kryetar z.Murrem Bushati, Lushnjë me kryetar z.Illaz Ahmeti, Krujë me kryetar z.Fadil Veseli; Lezhë me kryetar z.Loro Gjeçi, Tropojë me kryetar z.Hamit Nezirri; Fier me kryetar z.Nazif Ago, Mat me kryetar z.Ismail Muharremi, si dhe në të gjitha rrethet e vendit. Vlen të përmendet kontributi i veteranëve Fluturak Vinçani (Korçë), Genc Ballanca (Durrës), Osman Xhindoli (Shijak), Trifon Llupo (Tiranë), Muharem Kamani (Permet), Xhemal Meçi (Pukë), Ali Demushi(Shkodër) etj.

Pas viteve 90 dhe ndryshimeve demokratike që ndodhën në Shqipëri, një kontribut dha edhe Organizata e Bashkuar e Veteranëve të Luftës së Popullit Shqiptar (OBVL). Është i njohur kontributi i saj gjatë procesit të ndryshimeve demokratike e deri më sot.

Libri që u botua para gjashtë vitesh në 20 vjetorin e OBVL pasqyron gjërësisht, ndonjëherë edhe në detaje, pa pretenduar se ka thënë gjithçka, punën e madhe të mbi 15 mijë veteranëve që milituan dhe militojnë aktualisht (si anëtarë dhe pasardhës), në të mirë të demokracisë shqiptare dhe të së ardhmes së brezave, duke pasqyruar sa më drejt këtë luftë legjendare që e renditi Shqipërinë në krahun e fitimtarëve të Luftës së II-të Botërore.

Që nga krijimi i saj në korrik 1994, OBVL ka mbajtur shtashtë kuvende kombëtare, ku më i fundit, ai i datës 1 Nëntor 2019 shënoi një rekord anëtarësimesh të reja nga pasardhësit.

Gazeta Veterani, organ i OBVL pasqyroi dhe pasqyron vazhdimisht veprimtarinë e kësaj organizate dhe ka ndihmuar në realizimin e objektivave dhe detyrave të saj.

Përveç përvjetorëve të shokëve të rënë në luftë, të pushkatuarit nga diktatura, të vdekurit në burgje e internime, si dhe të figurave patriotike me kontribute të veçanta në luftat për liri kombëtare, përkujtimeve të shokëve që kanë vdekur

gjatë kësaj periudhe, veprimtarive të tjera në bashkëpunim me pushtetin vendor në përjetësim të LANÇ, OBVL u bë promotor në mbrojtje të luftës së UÇK dhe të luftës së Kosovës, të mbrojtjes së të drejtave të shqiptarëve në Kosovë, Preshevë, Maqedoni, Mal të Zi, të komunitetit çam etj.

Në përkujtim të këtyre ngjarjeve e figurave, OBVL në qendër e rrethe ka bashkëpunuar me organet e pushtetit, organizatat e shoqatave që zhvillojnë veprimtari shoqërore e patriotike.

OBVL ishte nismëtare në bashkimin e 64 organizatave e shoqatave joqeveritare që u angazhuan totalisht në mbështetje e ndihmë të luftës çlirimtare (UÇK) në Kosovë. Organizata jonë e ka mbështetur edhe Luftën e Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare të shqiptarëve në Maqedoni e Luginën e Preshevës për të fituar liritë nacionale e të drejtat njëzëre. Ne kemi mbështetur e mbështesim komunitetin çam në përpjekjet për të fituar të drejtat e mohuara.

Që në ditët e para të çlirimit të Kosovës kemi OBVL ka vendosur lidhje e bashkëpunim të ngushtë me Organizatën e Veteranëve të LANÇ të Kosovës; bashkë kemi përkujtuar shumë ngjarje të luftimeve për liri e pavarësi e në veçanti ato të LANÇ. Kemi krijuar dhe kemi lidhje të ngushta mes dy kryesive të shoqatave tona. Kryetari i OBVL-së, kolonel Myfit Guxholli, ruan në kujtesën e tij figurat e paharruara drejtuese të kësaj organizate si: Ramadan Vraniqi, Xhevdet Pula, Vahide Hoxha, Vehap Shita, Pajazit Nushi, etj, me të cilët ka patur bashkëpunim të frytshëm. Ndërsa tani ai ndjehet nderuar që bashkëpunon me të respektuarit Zija Mulhaxha, Skënder e Lek Hoxha, Drita Rexhepi, Bashkim Hisari e anëtarë të tjerë të Kryesisë të kësaj organizate, bashkëpunim që ka rezultuar në veprimtari të përbashkëta si në Shqipëri dhe në Kosovë. Organizata e Bashkuar e Veteranëve të LANÇ të popullit shqiptar është anëtare e Federatës Europiane e Botërore të Veteranëve. Me pjesëmarrjen dhe aktivitetet e këtyre federatave, jo vetëm në Europë, por edhe në Maljazi, në Johannesburg, Marok etj kemi bërë të njohur kontributin e popullit shqiptar në Luftën e II-të Botërore dhe të luftimeve për liri të popullit tonë në Kosovë, Maqedoni e deri dhe kontributin që japim sot në mbrojtje të paqes në kuadrin e NATO-s.

Me datë 1 nëntor 2019 në Akademinë e Shkencave të RSH u mbledh Kuvendi i VII-të Kombëtar i OBVL (Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare të Popullit Shqiptar). Ky kuvend mbledhëj 6 javë pas ndarjes nga jeta të kryetarit të OBVL, Heroit të Popullit, Nderi i Kombit Gjeneral Rrahman Parllaku. Gjeneral Parllaku u nda fizikisht, por ai do të mbetet nderi dhe lavdia e kësaj organizate. Kuvendi votoi unanimisht që z.Myfit Guxholli të zgjidhet kryetar i OBVL-së, i cili më pas mbajti raportin për veprimtarinë e organizatës nga Kuvendi i VI e deri më sot.

Halil Rama
Sekretar i Përgjithshëm
Muharrem Gjoka
Nënkryetar i OBVL



DEKORIMI

Presidenti Meta çmon etnomuzikologun e shquar

Ramadan Sokoli me Dekoraten “Nderi i Kombit”

Presidenti i Republikës, Sh.T.Z. Ilir Meta çmoi etnomuzikologun, kompozitorin dhe pedagogun e shquar Ramadan Sokoli (pas vdekjes) me Dekoraten e lartë “Nderi i Kombit”, me motivacionin: “Në shenjë vlerësimi dhe mirënjohjeje si themelues i etnomuzikologjisë shqiptare, muzikolog, kompozitor e pedagog. Vepra e tij studimore e muzikore është pjesë e patjetërsueshme e identitetit kulturor evropian të shqiptarëve. Kontributet e tij të jashtëzakonshme kanë bërë që të flasin shqip zbulimet e arkeologjisë sonë muzikore, duke dhënë përgjigje shtruese për mënyrën e organizimit dhe tipologjisë bazë të folklorit muzikor shqiptar, brenda dhe jashtë kufijve shtetërorë të vendit tonë”.

Në fjalën e Tij përshëndetëse, në ceremoninë solemne të organizuar, Presidenti i Republikës shprehu kënaqësinë dhe privilegjin që po nderon një nga personalitetet më të rëndësishme të kulturës dhe artit kombëtar.

“Profesor Ramadan Sokoli lindi 100 vjet më parë në qytetin e Shkodrës, ndërsa në Vlorë kishin nisur krismat për të hedhur në det pushtuesit e fundit që kishin mbetur në tokën tonë.

Viti 1920 është një vit i bekuar në historinë e kombit e të shtetit shqiptar. Nis me një ngjarje të madhe siç ishte Kongresi i Lushnjes. Vazhdoi me një ngjarje tjetër në Paris, shumë të madhe që gjithashtu ishte një akt shtetformues. Dhe përfundoi me hedhjen në det të pushtuesve të fundit, duke i dhënë kështu jetë shtetit shqiptar dhe kurorëzuar me sukses ato tetë vite aq të mundimshme, të lodhshme e rraskapitëse që nga 28 Nëntori 1912.

Profesor Ramadan Sokoli kaloi nëpër shumë sfida jetësore duke u shndërruar në një shtyllë të patjetërsueshme referimi për zbulimin dhe shpalosjen e vlerave të jashtëzakonshme kulturore të kombit tonë.

Ai rridhte nga një familje atdhetare dhe qytetare shkodrane, i mëkuar që



në djep me patriotizëm nga familja historike e Sokolëve, si pasardhës i denjë i Hodo Pashë Sokolit, njërit prej komandantëve kryesorë të Lidhjes së Prizrenit.

I kthyer plot me ëndrra nga studimet në atdhe, pas Luftës së Dytë Botërore ai u burgos padrejtësisht nga diktatura komuniste, që u mundua më kot të thyente karakterin e paepur të këtij burri kryelartë e fisnik shqiptar.

Profesor Sokoli pavarësisht kalvarit personal dhe persekutimeve si familje ia doli të ngrihej mbi presionin dhe vështirësitë e kohës falë talentit, dinjitetit, formimit kulturor, pasionit dhe trashëgimisë shpirtërore të familjes!

Në moshën 16 vjeç Profesor Ramadan filloi të sjellë në jetë këngët e para si: ‘Blegëron delja’, e më pas, këngën ‘Lulja me erë’, që në demonstratat e viteve ‘80-‘82 në Kosovë e në mbarë viset ku jetonin shqiptarët, u përhap si hymn frymëzues kushtuar lirisë.

Në vitin 1954, si pedagog i ri në Liceun Artistik ‘Jordan Misja’, ai trajtoi për herë të parë lëndën e Folklorit Muz-

ikor duke hapur një kapitull të ri në etnomuzikologjinë shqiptare, që nuk ekzistonte deri në fillim të viteve ‘50-të.

I gjithë kontributi etnomuzikologjik i profesor Sokolit është një enciklopedi e mbartjes dhe e shpjegimit të dukurisë së folklorit muzikor shqiptar në kohë dhe hapësirë shumë të gjerë.

Talentin dhe kapacitetin profesional Profesor Sokoli e tregoi edhe në udhëheqjen e ekspeditave hulumtuese, bashkë me studiues gjermanë, rumunë, etj., në krahina të ndryshme të Shqipërisë, me të cilat pasuroi Fonotekën e Institutit të Folklorit shqiptar.” – vuri në dukje Presidenti Meta.

“Vlerat e veprës së Profesor Sokolit janë ravijëzuar së bashku me rritjen profesionale, shkencore dhe artistike të vetë autorit.

Ajo çka i ka ngjizur ato në një unitet të vetëm rrezatues, është shpirti, puna dhe përkushtimi i tij prej rilindësi të vërtetë.

Falë kontributit të tij të jashtëzakonshëm dhe interpretimeve të tij shken-

core, kanë folur shqip zbulimet e arkeologjisë sonë muzikore sikurse janë të mëdhenjtë Niketë Dardani, Jan Kukulzeli e Danush Lapacaja si edhe figura e Heroit tonë Kombëtar, Skënderbeut në muzikë.

Gjithashtu janë kryer studime thelbësore për mënyrën e organizimit dhe tipologjitë bazë të folklorit muzikor shqiptar duke filluar prej veglave tona muzikore e deri te përgjigjet e ndërlikuara të origjinës së muzikës sonë popullore, brenda dhe jashtë kufijve tanë shtetërorë.

Po kaq të rëndësishme e konsiderojmë edhe krijimtarinë e tij muzikore të të gjitha llojeve dhe gjinive mbështetur në vlerat e etnomuzikës; e po aq edhe konstatimi se në studimet e tij albanologjike, vështrimi etnomuzikologjik i problemit albanologjik është më se origjinal.

Duke theksuar se puna e tij e jashtëzakonshme u krye pa mbështetjen e duhur dhe pa kujdesin e veçantë që meritonte ky kolos i trashëgimisë sonë shpirtërore kombëtare, vepra e tij bëhet edhe më e çmuar sot.

E gjithë vepra e tij mban vetëm vulën e punës së palodhur, të kryer jashtë ambienteve të institucioneve zyrtare të studimit të traditave, nën kujdesin e veçantë edhe të zonjës Lili, gruas së tij të dashur dhe të përkushtuar ndaj tij deri në çastet e fundit. Asaj ai i ka kushtuar veprën ‘16 Shekuj’, për shkak të dashurisë dhe kontributit të saj për veprën e përbashkët.

Vepra e tij studimore dhe muzikore tashmë është pjesë e identitetit kulturor evropian të shqiptarëve.

Emri i tij renditet në enciklopeditë e huaja krahas më të mëdhenjve etnomuzikologë të botës.

Pas viteve 1990-të vlerat e kontributit të tij u rivendosën në pedestalin e merituar, i kërkuar në gjithë hapësirën shqiptare si udhëheqës e drejtues artistik i shumë festivaleve folklorike kombëtare e rajonale.

Krijimtaria e tij studimore vazhdoi deri në çastet e fundit të jetës. Me veprën e tij të jashtëzakonshme profesor Ramadan Sokoli është bërë tashmë pjesë e panteonit të personaliteteve më të shquara të kombit tonë.

Për profesor Ramadan Sokolin do të ketë vetëm ditëlindje! – theksoi Presidenti Meta, duke i dorëzuar zonjës Linda Sokoli-Duma dekoratën e lartë për babain e saj.

Në ceremoninë solemne, ku ishin të pranishëm familjarë e të afërm, miq e kolegë, muzikologë, artistë dhe personalitete, fjalën e hapjes e mbajti Zhani Ciko, dhe më pas u luajtën disa pjesë muzikore nga veprat e Ramadan Sokolit, të interpretuara nga artistët Shqipe Zani dhe Kastriot Tusha.



DEKLARATA

Ministeriali i Mbrojtjes, Xhačka konfirmon: Do jemi në Kosovë, Afganistan, Letoni



Shqipëria rikonfirmon pjesëmarrjen e saj në të gjitha misionet, ku Forcat e Armatosura janë të angazhuara. Kështu ka theksuar ministrja e Mbrojtjes e Shqipërisë, Olta Xhačka, gjatë Ministerialit të Mbrojtjes të 30 vendeve anëtare të NATO, i mbledhur për të dytën herë online për shkak të COVID - 19. Ky takim ishte parashikuar që të mbahej në Tiranë, por

pandemia e tre muajve të fundit bëri të pamundur organizimin në vendin tonë, të një prej eventeve më të rëndësishme vjetore të Aleancës.

Ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhačka gjatë fjalës së saj, tha se “Shqipëria konfirmon praninë e saj në Kosovë, Afganistan, Letoni dhe po punojmë për një mision të përbashkët në Irak në kuadër të Kartës së Adriatikut, drejtimin e së cilës e ka vendi ynë. Vlerësim për burrat dhe gratë në uniformë, kontributi i të cilëve janë siguria që misionet e operacionet të vazhdojnë pavarësisht pandemisë”.

Ministrja e Mbrojtjes propozoi fokus të veçantë të NATO-s për mbrojtjen dhe deterrancën në krahun jugor të Aleancës.

Duke vlerësuar rolin vendimtar që NATO ka në mbrojtjen e rendit global, bazuar në vlerat e përbashkëta, ministrja e Mbrojtjes tha se një aleancë e bashkuar dhe solidare është përgjigja më e mirë ndaj çdo rivali gjeopolitik të NATO-s.

Në qendër të diskutimeve të dy ditëve të Ministerialit, ishin misionet e operacionet e NATO-s si, si dhe mbrojtja e deterranca në Aleancën më të madhe ushtarake në botë.

DITËLINDJA

Në 65 vjeçarin e ditëlindjes së ushtarakut, krijuesit, shkrimtarit, historianit dhe profesorit të mirënjohur

BERNARD ZOTAJ, PROFESORI I HISTORISË USHTARAKE DHE TREVËS SË LABËRISË

Prof. Asoc. Dr. Zaho Golemi

NË FAMILJEN ZOTAJ ME TRADITA ATD-HETARE

Në jetën e njeriut 65 vjetori është një shifër, një station jetësor, që vjen natyrshëm. Ushtaraku Bernard Zotaj lindi në Ramicë të Vlorës, në këtë truall atdhetar që ka një histori të lashtë, ku për shekuj me radhë, krenaria, dinjiteti dhe të jetuarit me nder ishte detyrë e detyrim brezash. Familja e tij, në shekuj ka qenë atdhetare dhe patriotike, duke qenë pjesë e aktivitetit ndihmues në ngjarjet vendore dhe kombëtare. Stërgjyshërit krijuan histori dhe i shtuan lavdi fisit Zotaj, ndërkohë që gjyshërit dhe prindërit e tij, gjatë LANÇ-it, dhanë një kontribut të vlerësueshëm dhe e kthyen shtëpinë në bazë të luftës për zonën e Vlorës.

Bernardi erdhi në jetë më 8 qershor 1955, në një familje të madhe me oxhak dhe me histori, me plot motra e vëllezër. Që prej asaj ditë djali i përkundur në djep në një fshat të ashpër por krenar për të shkuarën dhe për të ardhmen që e priste e përligji krenarinë dhe përkujdesjen e dashurisë njerëzore prindërore.

Pas shkollës 8 vjeçare në Ramicë, Orikumi do bëhej stationi jetësor shkollimi pas vëllait të madh, Kastriot Zotaj, farmacist ushtarak. Në vitet 1970-1974 kreu me sukses të plotë shkollën e mesme të përgjithshme "Hasan Pulo" në Orikum të Vlorës. Shpejt do të çelej hapësira edukimi në nivele gjithnjë e më të larta, arsimimi akademik në shkollën e burrave, ku formohej trupi dhe mendja për të shërbyer në një prej sektorëve më jetikë të vendit, siç ka qenë mbrojtja e vendit, komandant e komisar, sekretar e pedagog, shëf e drejtues të niveleve të larta, por që bazën e misërniken e fshatit nuk e harroi kurrë.

Vazhdimësia e vrullshme në gjurmët e të parëve e çoi natyrshëm në progres e përparim duke mos e parë jetën të shkëputur nga shoqëria, vëllezëria, familja nga Tirana, në Shkodër dhe në të gjithë Shqipërinë. Akademik e shoqëror, i mirësjellshëm në situata komplekse, që di ta mbajë timonin njerëzor, jashtë komandave e urdhrave, por me mirësjellje të spikatur, prodhimtar në profesionin e historianit ushtarak, kërkues e ideator në forumet e komiteteve, organizatave e shoqatave, i qeshur dhe i kujdesshëm në të gjitha veprimet.

NË PROVËN E JETËS USHTARAKE

Endërra labe për t'u bërë oficer dhe për të shërbyer në radhët e djalërisë që mbronte vendin vazhdonte. Kështu shtatori i vitit 1975 e gjen në Tiranë në auditorët e blerta. Këshu, që në shtator 1975-maj 1979 përfundon Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerave me rezultate të shkëlqyera. Duke qenë rezultativ në punë përzgjidhet në shtator 1987 për vijimin e studimeve të thelluara ushtarake në Akademinë e Mbrojtjes në Tiranë, ku edhe në këtë kulm të arsimimit ushtarak me dije të thelluara operativ-strategjike ushtarake shkëlqen mes akademistësh dhe meriton vlerësimin "Shkëlqyeshëm". Duke mos u ndalur në lëmin e studimeve vijon kualifikimin me kurse kualifikimi në fushën e historisë ushtarake dhe sigurisë.

Viti 1979 ishte viti ballafaqohet me trupat. Emërohet komandant toge këmbësorie në 1979 dhe në vitin 1983 kryen detyrën e komisarit të kompanisë dhe të sekretarit të komitetit të BrK në qytetin e Durrësit. Në vitet 1983-1987 kreu detyrën e Sekretarit të Komitetit të Rinisë të të Shkollave Ushtarake të Shqipërisë, si dhe dha mësim në lëndët shoqërore në Shkollën e lartë ushtarake. Me përfundimin e Akademisë Ushtarake në vitet 1989-1996 kreu detyrën e komisarit të Brigadë Këmbësorie në Vaun e Dejës, si dhe komandant dhe shëf shtabi bk në repartet e Tiranës. Në vitet 1998-2001 kreu detyrën e shefit të inspeksionit në Akademinë Ushtarake "Skënderbej", specialist në Qendrën



e Taktikës dhe pedagog në Akademi. Në periudhën 2001-2006 kreu detyrën e shefit të Botimeve në Qendrën e Doktrinës, kryeredaktor i "Revistës Ushtarake" dhe pedagog në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes. Në vitet 2006-2011 drejtoi sektorin e Historisë Ushtarake në Akademinë e Mbrojtjes dhe pedagog. Në vitet 2011-2012 ishte pedagog në SHLP "Vitrina", dekan i Fakultetit të Shkencave Politike. Në vitet 2012-2014 kreu detyrën e Drejtorit të Qendrës së Librit dhe Mbështetjes me Informacion në KDS.

Prej tetor 2014 dhe deri daljen në pension kreu detyrën e Specialistit në Qendrën e Doktrinës dhe të Kërkimit, pedagog në Akademinë e Forcave të Armatosura. Gjatë tërë kasaj periudhe mbi 40 vjeçare në shkollat ushtarake dhe reparte të ndryshme ka publikuar në vijimësi shkrime për fushën e mbrojtjes, të sigurisë dhe të historisë ushtarake shqiptare dhe botërore. Ai ka qenë tërësisht i angazhuar me sfidat e kohës ka qenë pjesëmarrës në dhjetra konferenca dhe sesione shkencore, brenda dhe jashtë vendit, të nivelit kombëtar e ndërkombëtar, si në Tiranë, Tetovë, Prishtinë, Kroaci, Budapest, Podgoricë; por edhe në Universitetet shqiptare si në Vlorë, Gjirokastrë, Elbasan, Korçë, Shkodër, duke e bërë një ushtarak me dije të thella por edhe një pedagog që ka rezatuar krijimtari shkencore me kumtesat interesante të fushës së historiografisë.

NJË BOTË E PASUR ME PUBLIKIME DHE VLERËSIME

Në fakt ai ishte i vetëfutur dhe që e kishte detyruar veten si prerje studiuesi kur ishte që në fëmijëri "mik i librit", kur librat ishin pasuri e cmuar e cdo periudhe të jetës së tij. Kështu ai ka zhvilluar një sërë aktivitete akademike dhe botime në revista të ndryshme shkencore, si dhe libra e materiale mësimore. Publikimi i mëse 20 monografive si "Oxhaku i Zote në Smokthinë", "Malli për Nënë", "Nderim Egerem Sinanit", "Rrëfimet e Nënë Zybës", "Konaku i Habil Laçes në Tragjas", "Dreri i bukur i Ramicës", "Biseda me babain vazhdon...", "Thëllëza e Mesaplikut", "Këshilltar nderi i Kuçit", "Së bashku..." në dy vëllime (për ushtarakë të dalë në rezervë nga KDS-ja), "Njeriu i hapësirave të gjelbërta", "Njeriu i bukur", "Shpirti i brezit të gurtë", "Prushi i Labërisë", "Poeti i Labërisë Lirim Deda", "Xhenieri i martirizuar", "Yjet e Ramicës"... etj., është një pasuri e trashëgimi brezash, që gjenden kudo në Bibliote-

ka, arkiva, në muzeume.

Është bashkëautor i tekstit të Historisë së Shqipërisë për Klasën e 9 dhe të 12 (2011-2012), të aprovuar nga Ministria e Arsimit dhe e Sporteve. Është autor dhe bashkëpunëtor në librat "Zona e Parë Operative Vlorë-Gjirokastrë-Mallakastër 1943-1944" (2003), "Armed Forces in Photos the History" (2005), "Manuali i Ushtarit" (2006), "Guidë e Historisë Ushtarake" (2008), "Shqipëria dhe Luftërat Ballkanike" (2008), "Figurat kryesore të Luftës së Dytë Botërore" (2009), "Teori të Luftës dhe Strategjisë" (2011), "Dëshmorët e Atdheut" (2012), "Arti Ushtarak në Luftën e Vlorës të vitit 1920" (2016).

Është anëtar i Institutit të Studimeve të Historisë Ushtarake, anëtar i bordit të Revistës "Studime për Historinë Ushtarake", Kryetar i Shoqatës së Historianëve Ushtarak të RSH, anëtar i Kryesisë së Organizatës së Veteranëve të LANÇ-it, anëtar i Kryesisë Kombëtare të Dëshmorëve të LANÇ-it dhe dëshmorëve të tjerë të Atdheut, si dhe anëtar i kolegiumit të redaksisë të revistës "Pavdekësia".

Gjatë karrierës ushtarake ka pasur gradat ushtarake duke filluar nga Kapiten i Parë, major dhe nënkolonel. Gjatë dy dekadave të fundit ka fituar me plot meritë gdatën shkencore "Dr." dhe titullin akademik "Prof. Asoc.". Komisioni i Kualifikimit Shkencor pranë Këshillit të Ministrave i ka dhënë "Doktor i Shkencave" në fushën e mbrojtjes me nr. Rregjistrimi 4231, dt. 29.07.03, ndërsa titulli akademik "Prof. Asoc." i është akorduar nga këshilli i profesorëve të Akademisë së Mbrojtjes dhe të miratura me nr. 404 në MAS në vitin 2011.

Për rezultate, disiplinë dhe veprimtari është vlerësuar me certifikata, fletë nderi, si dhe me dekorata si Medalja e "Shërbimit Ushtarak", Urdhërin "Për shërbime të shquara shtetërore dhe shoqërore" të Klasit III, Urdhërin "Shërbimi Ushtarak" të Klasit të III, Medalja e "Karrierës" dhe Medalja "Për shërbime të veçanta".

Gjithashtu vlerësuar nga Shoqata Kulturore Atdhetare "Labëria" "Nderi i Kombit", me diplomë "Personalitet i shquar i Labërisë" dhe nga Organizata e Dëshmorëve me titullin "Nderi i Organizatës Kombëtare për Dëshmorët e LANÇ dhe Dëshmorë të tjerë të Atdheut". Edhe pas këtyre nderimeve sfida e tij ka qenë dhe ka ngjellur kërkimi shkencor akademik si një sfidë triumfi në jetë.

SHOQËRIA DHE AKTIVITETI SHOQËROR

Bernard Zotaj, i cili ka 45 vite shkollë, shërbim ushtarak, aktivitet pedagogjik, një copëz të zemrës e ka lënë në vendlidje, tek bashkëfshatarët që e duan gjithmonë të ri ndaj edhe i thonë me zemër "mos u plaksh kurrë"! Devotshmëria ndaj Atdheut, me të cilën ushtaraku Bernard Zotaj shërbeu në Fushë-Krujë, Durrës, Has, Tropojë, Shkodër e Tiranë e bën ndër njerëzit krenar, të nderuar dhe të respektuar. Vartësit dhe kolegët e kanë vlerësuar dhe respektuar si etalonin e ndershmërisë, dashurisë njerëzore dhe sakrificave.

Edhe pse largohet nga ushtria e ndjen veten i plotësuar sepse e ka kryer me nder e dinjitet misionin fisnik dhe me zemër i uroj vijimësi, zhvillim e modernizim të mëtejshëm të FA. Është një jetë në shërbim të Atdheut që meriton vetëm respekt, në detyrat e komandantit dhe të komisarit, drejtues i spikatur rinie, pedagog e drejtor, Shëf i Historisë ushtarake, punonjës kërkimor shkencor i apasionuar pas shkencës së historiografisë ushtarake e më gjerë, i nderuar e respektuar nga të gjithë brezat e studentëve dhe të kursantëve. Shokë e miq, kolegë ushtarakë e ish-ushtarakë, kolegë të komunitetit të historianëve ushtarakë e më gjerë i urojmë: Gëzuar Profesor Berti 65 vjetorin e lindjes!

21 VJET MË PARË

ZBARKIMI I TRUPAVE TË NATO-s NË KOSOVË DATË HISTORIKE PËR SHQIPTARËT

NATO-ja i dha fund një konflikti të tmerrshëm në Kosovë

Nga Bashkim Hisari

21 vjet më parë, më 12 qershor 1999, forcat ushtarake të NATO-s, përkatësisht trupat shumëkombëshe të KFOR-t i dhanë fund një konflikti të tmerrshëm në Kosovë. Por, në Kosovë, kjo datë, nuk ka statusin e festës zyrtare. Si zakonisht në Kosovë gjithëçka po polemizohet, pra edhe dita e lirisë dhe e çlirimit. Mospajtime dhe dilema ekzistojnë rreth asaj se cila është data e çlirimit: dita kur kapitulloi Federata Jugosllave me aktin e nënshkrimit të Marrëveshjes së Kumanovës, apo dita kur në Kosovë u zbarkuan trupat shumëkombëse të NATO-s bashkë me luftëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK-s), ose dita kur nga Kosova u largua ushtari i fundit serb? Megjithatë, për kosovarët, 12 qershori është ditë e veçantë, ditë e lirisë dhe e çlirimit. Datë historike për shkak se përfundoi periudha e gjatë që ishte shumë e vështirë për popullin shqiptar të Kosovës i cili përjetoi krimet më mizore.

Në këtë periudhë, dhuna dhe terrori serb ndaj popullit shqiptar është manifestuar në mënyra të ndryshme. Ato kanë qenë të organizuara nga shteti me pjesëmarrjen e formacioneve ushtarake, policore, paramilitare dhe nga një pjesë e serbëve lokal të cilët kanë vrarë shqiptarët duke mos kursyer fëmijë, gra dhe burra të moshuar.

Faktet për krimet e serbëve tregojnë se në Kosovë janë kryer rreth 400 masakra, janë vrarë 1.393 fëmijë shqiptarë, 1.379 gra shqiptare dhe mbi 13.510 civilë. Kriminelët serb kanë zhvendosur kufomat, kanë plaçkitur, djegur shtëpitë dhe kanë shkatërruar pronën private e fetare. Llogaritet se rreth 20 mijë femra kanë qenë viktimat të dhunës seksuale. Dhunshëm nga Kosova janë dëbuar afro një milionë njerëz. Në varrezat masive në Batajnicë, Peruçac, Petrovo Selo, Rudnicë të Rashkës në Serbi janë gjetur trupat e viktimave shqiptarë. Mbi 1.600 persona janë ende të pagjetur.

Gjykata Ndërkombëtare për Krimet e Luftës në ish-Jugosllavi bëri hetime të plota të krimeve të luftës në Kosovë. Me akt-akuzën e Gjykatës kundër Slobodan Milosheviq, presidentit të ish-Jugosllavisë dhe katër zyrtarëve të tjerë të lartë, ata u akuzuan për vrasje, persekutime dhe dëbime nga Kosova.

Përkundër kësaj, institucionet dhe liderët politikë në Kosovë, nuk janë angazhuar sa duhet që kriminelët të dalin para drejtësisë dhe të marrin dënimet e merituar. Në anën tjetër Serbia nuk pranonë se është përpjekur të kryej akte gjenocidi në Kosovë, nuk po i dënon kryesit e krimeve dhe asgjë nuk po bënë ta ndriçojë fatin e të pagjeturve dhe të riparojë dëmet e shkaktuara.

Pos fushatës 78 ditëshe të bombardimeve të NATO-s mbi caqet serbe, dhe luftës së UÇK-s kundër forcave ushtarake policore serbe, lirisë dhe çlirimit të Kosovës i kanë parapri edhe disa ngjarje të rëndësishme.

Më 9 qershor 1999, në qytetin e Kumanovës, u arrit marrëveshja e cila njihet si Marrëveshja ushtarako-teknike, me të cilën iu dha fund luftës në Kosovë, duke u dorëzuar ish-ushtria e Jugosllavisë dhe kapitulluar kriminelin Slobodan Milosheviq. Një ditë më pas, më 10 qershor, NATO pezulloi operacionet. Me këtë marrëveshje, Serbia është detyruar të tërheqë të gjitha forcat e saj policore dhe ushtarake nga Kosova. Në të njëjtën ditë, Këshilli i Sigurimit të OKB-së miratoi Rezolutën 1244 e cila përcaktoi statusin politik të Kosovës.

Tribunali i Hagës për krimet e luftës në



ish - Jugosllavi, ka konstatuar më vonë në vendimet për dënimin e ish-krerëve të Serbisë dhe ish-Jugosllavisë se forcat serbe kanë bërë përpjekje për spastrim etnik në Kosovë, përmes vrasjeve dhe dëbimeve masive të shqiptarëve.

Por, që të arrihet kapitullimi i Serbisë dhe që të përmbyllet çlirimi dhe pavarësia e Kosovës kanë ndikuar edhe një varg ngjarjesh historike dhe veprime të mahershme të cilat fatëkeqësisht jo rrallë nënvlersohen, minimizohen dhe relativizohen.

Pjesëmarrja e kosovarëve në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare (LANÇ) që u zhvillua në kushte të vështira të eksploatimit shekullor të popullatës shqiptare, ka pasur një rol të veçantë. Duke parë perspektivën e çlirimit, shqiptarët u inkuadruan që në fillim të luftës kundër fashizmit dhe bashkë me luftëtarët e Shqipërisë dhanë kontributin e tyre të madhë,

ME PJESËMARRJEN E SHQIPTARËVE NË LANÇ U VENDOSËN BËRTHAMAT E PARA TË SHTETËSISË SË KOSOVËS.

Konferenca e Pestë e Partisë Komuniste të Jugosllavisë (PKJ) që u zhvillua në tetor të vitit 1940 mori qëndrim që edhe Kosova të ketë pozitën e njëjtë juridiko-shtetërore si krahinat tjera. Më vonë, kur u shtrua çështja kombëtare, funksionari i lartë i PKJ, bashkëpunëtori më i afërt i Titos, njëri prej përpiluesëve të vendimeve të AVNOJ -it dhe Kushtetutës së

RFPJ Mosha Pijade, theksoi se zhgjidhja e çështjes kombëtare mund të arrihet me “formimin e republikës së Kosovës së lirë punëtore-fshatare, nëpërmjet përmbyshjes revolucionare të regjimit serbomadhfashist imperialist”. Këto qëndrime parimore patën ndikim vendimtar që në ndërdijen e masave të gjëra të depërton e vërteta jo vetëm se LANÇ është luftë për çlirimin e plotë kombëtar, por njëherit edhe për një shoqëri të re dhe përparim të ri shoqëror. Kjo ndikoi që të shtohet numri i njësisë partizane të armatosur dhe të themelohen organet e pushtetit popullor respektivisht bërthamat e para të pushtetit të ardhshëm të Kosovës. Rreth 53, kosovarë u përfshinë në LANÇ prej të cilëve mbi 6200 ranë dëshmor për lirinë e vendit. Shqiptarët ishin të bindur se në të ardhmen do të trajtoheshin në mënyrë të barabartë në federatën e ardhshme Mirëpo, disa komunistë me orientim ekstremist, kërkuar me lënë mënjat këtë qëndrim. Në mbledhjen e parë e as në të dytën të KAÇKJ, shqiptarët – si popull i tretë në Jugosllavi – nuk u ftuan të marrin pjesë. Kosova nuk u përfshi si subjekt i pavarur që deri atëherë ishte përfaqësuar përmes Malit të Zi. Andaj, në Konferencën e Bujanit, u kundërshtuan vendimet AVNOJ -it dhe u diskutua për të ardhmen e Kosovës. Vendimi kryesor i Bujanit ishte nxitja e popullit shqiptar të Kosovës që të marrin pjesë bashkë në LANÇ dhe se ajo ishte luftë për të ardhmen e Kosovës për vetëvendosje.

Në Kosovë, gjatë luftës nacionalçlirimtare u krijua zona të cilat kanë qenë nën

kontrollin e këshillave nacionalçlirimtare dhe ato nuk kanë qenë nën komandën e Serbisë. Pikërisht nga kjo buron shtetësia e Kosovës sipas vullnetit të popullit.

Ndërhyrjes në Kosovë të forcave perëndimore që në atë kohë u quajt si “ndërhyrje humanitare” e që kishte për qëllim shpëtimin e shqiptarëve nga represioni i forcave serbe, pak a shumë i kanë paraprirë edhe disa ngjarje tjera.

Në pranverë të vitit 1989, në Kuvendin e Kosovës, në kundërshtim me vullnetin e qytetarëve, u ndryshua Kushtetuta e vitit 1974, me çka suprimua autonomia e Kosovës në Federatën Jugosllave, duke e lënë Kosovën si pjesë përbërëse të Serbisë, kurse popullatën shumicë nën masë represive dhe aparteidit. Në mbrojtje të pozitës kushtetuese të Kosovës minatorët e “Trepçës” organizuan grevën që lëkund themelet e ish Jugosllavisë.

Çlirimi dhe shtetësia e Kosovës është e lidhur ngusht edhe me Deklaratën Kushtetuese të 2 korrikut 1990 e shpallur nga 111 delegatë të Kuvendit të atëherëshëm të Kosovës. Deklarata zhvlerësoi Rezolutën e Konferencës së Prizrenit, të 10 korrikut 1945, me të cilën Serbia, pasi që kishte anulua me gjak Rezolutën e Bujanit, e aneksoi Kosovën.

Me shpalljen e Kosovës njësi të barabartë të federatës jugosllave, iu hapë rruga veprimeve të mëtutjeshme me të cilat u rrumbullaksua legjitimiteti i infrastrukturës demokratike të shtetit të pavarur të Kosovës.

Në Kuvendin e Kaçanikut më 7 shtatorit 1990, u shpall Republika e Kosovës. Një vjet më vonë u organizua Referendumi për Pavarësi, pastaj edhe zgjedhjet e para parlamentare dhe presidenciale të Kosovës me të cilat u rrumbullaksua legjitimiteti i infrastrukturës demokratike të shtetit të pavarur të Kosovës. Në atë kohë me rëndësi ishte edhe funksionimi i institucioneve të Kosovës. Edhe pse ishte vetëm Republika e Shqipërisë që e njohi pavarësinë Kosovës, Qeveria në egzil e mbante gjallë jetën institucionale të Kosovës.

Ngjarja më e rëndësishme për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës ishte 17 shkurti i viti 2008 Kosovës. Të mbledhur në mbledhje të jashtëzakonshme, atë ditë, në Prishtinë, duke u përgjegjur thirrjes së popullit për të ndërtuar një shoqëri që respekton dinjitetin njerëzor dhe afirmon krenarinë dhe synimet e qytetarëve, përfaqësuesit legjitim të popullit në Kuvendin e Republikës së Kosovës të zgjedhur në mënyrë demokratike, njëzëri shpallën Kosovën shtet të pavarur, sovran dhe demokratik. Në të njëjtën kohë qeveria serbe miratoi vendimin për anulimin e deklaratës për pavarësinë e Kosovës.

E VËRTETA E VDEKUR SERBE PËR KOSOVËN

Në Serbi e vërteta për Kosovën është e vdekur, ndonëse nuk ka ekzistuar kurrë. Vështirë është që Serbia të gjejë mundësi për të tejkaluar arrogancën e habitshme të liderëve të saj politikë, karshi Kosovës të krijoj një politik të drejtë dhe të ketë vullnetin për të gjetur zgjidhje të pranueshme për shqiptarët dhe serbët, për dy shtete fqinjë.

Mbi 100 shtete anëtare të OKB-së e njohën pavarësinë e Kosovës. Serbia e dërgoi në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë (GJND) ankesën e saj për shpalljen e pavarësisë dhe në korrik të vitit 2010, mori përgjigjen se Pavarësia e Kosovës “nuk bie ndesh me ligjin ndërkombëtar”. Gjatë fjalës së tij, Kryetari i Gjykatës Hia-

(Vijon në faqen 10)


PROFIL

VIRON CINXO - MËSUESI I MREKULLUESHËM, VEPRA ETËCILITMERITONVLERËSIMTËVEÇANTË

SHPENDI TOPOLLAJ

Kushdo që ka pasur fatin të studiojë në shkollën e mesme ushtarake “Skënderbej”, e ka shumë të qartë se dashuria dhe nostalgjia për të, por dhe vlerat kulturore dhe atdhetare me të cilat ajo shkollë na mbrujti, në radhë të parë, i përkasin punës së ndershme e plot pasion të trupës komanduese dhe asaj pedagogjike që u takoi të punonin me ata djem të ardhur nga të gjitha krahinat e Shqipërisë. Edhe tani në moshë të shtyrë, skënderbegasit e dikurshëm, u janë mirënjohës atyre, duke i nderuar dhe kujtuar me mall, por edhe u referohen gjithmonë si modele nga më të arrirat të aftësive profesionale, nivelit të lartë kulturor, përkushtimit në detyrë, dhe dashurisë për nxënësit e tyre. Dhe nuk gaboj aspak, po të them se njëri nga përfaqësuesit më dinjitozë të atyre mësuesve dhe mësuesve të mrekullueshme, mbetet Viron Cinxo, i cili për hidhërimin tonë të madh, gjashtë muaj më parë ndërroi jetë.

Trup vogël, por shumë i pashëm, energjik dhe elokuent, i rreptë, por tmerrsisht i drejtë me këdo, mjeshtër i të shpjeguarit thjeshtë e qartë të lëndës më të vështirë, fizikës, ai jo vetëm u bë njeriu më i respektueshëm i yni, por me mençurinë e tij, në sytë tanë krijoi aq besim, sa u bë i denjë për atë thënien e nxënësve të filozofit fizikant Aristotelit, mësuesit të Lekës së Madh: “Ipse dixit!”, pra “e ka thënë ai”, mësuesi, dhe kjo mjaftonte për të mos e zgjatur më tej. Me atë fytyrën përherë paqësore dhe atë shikimin e ëmbël të atyre syve të zinj, portreti i tij është gdhendur së bashku me ato fjalët lapidare se “ju duhet të mësoni për jetën dhe jo për shkollën”. Fillimisht, mes nesh kishte diferenca, pasi kishte atje djem nga kryeqyteti me ballarët gjeneralë, kolonellë a intelektualë të njohur, por edhe barinj që vinin ndofta për herë të parë në Tiranë nga zona të thella e të pazhvilluara, por për mësuesin tonë, ne ishim të gjithë të barabartë. Ai, na trajtonte me shumë takt, pasi nga përvoja e tij e dinte se ne do bëheshim të gjithë të



luara, por për mësuesin tonë, ne ishim të gjithë të barabartë. Ai, na trajtonte me shumë takt, pasi nga përvoja e tij e dinte se ne do bëheshim të gjithë të

mirë, ndaj përherë në bisedat që bënte me ne, dukej se udhëhiqej nga thënia e La Roshfukosë se “Vlera e bisedës së vërtetë qëndron në thënien e gjithë asaj, që është e nevojshme, e në të mos thënit e asaj që nuk është e nevojshme”. Nuk fliste për ato që na ndanin, por për gjithçka që na bashkonte. Fjala dhe qëndrimi i tij ngjallnin besim dhe optimizëm te ne, e mbi të gjitha dashuri për jetën e vendin tonë. E dinte se ai nuk ishte thjeshtë një mësues i yni, por ishte njëkohësisht një edukator.

Një edukator nga ata që jepnin shembullin dhe frymëzonin me pamjen, gjestet dhe fjalët e matura. Përherë i veshur me shije, me kostum të rregullt e kravatë, i hekurosur dhe me këpucë të llustruara, ai sapo futej në klasë, pasi vendoste regjistrin mbi tavolinë, na hidhte shikimin të gjithve me radhë, sikur donte të na psikologjiste apo të informohej në ishim përgatitur për mësimin e ditës. Ndërkohë, pasonte një heshtje e cila më pas kthehej në vëmendje, derisa e ndiqnim tërë sy e veshë gjatë gjithë orës së mësimi. Kurrë nuk e pamë t'i bënte ndokujt vrejte, të qortonte dikë apo të nxirrte ndonjërin nga klasa.

Autoriteti që ai gëzonte mes nesh, nuk lejonte as më të voglin çapkëllëk. Dhe në pushim, e shihnim mes kolegëve, duke u interesuar dhe pyetur ata për klasën që kishte në kujdestari. Dhe këtë kujdes ai e ruajti deri vonë, kur u caktua Nëndrejtor i Drejtorisë së Personelit në Ministrinë e Drejtësisë. Personalisht e ndieva këtë, pasi duke qenë jurist, dhe u suprimua vendi im, bëri të gjitha përpjekjet për të më caktuar në Përmbarimin Gjyqësor, pa humbur as edhe një ditë.

Më ka mbetur merak që nuk arrita të pija me të një kafe. Ai ishte nga ata që nuk e shiste kurrë nderin që bënte. Dhe kur erdhi një herë në Durrës së bashku me familjen dhe ju luta të uleshim diku, përsëri m'u shmang. Atëherë, nuk m'u ndenjti pa e pyetur se ku qëndronte sekreti që edhe pse jepte lëndën më të vështirë, edhe pse më së shumti ishte aq serioz, përsëri ne e donim aq shumë. Më tha: “Vërtetë nuk e di? Po a mban mend të kem mbetur ndonjë skënderbeg në klasë?” Po! U kujtova që ai punonte me të gjithë, si gjatë mësimi, ashtu edhe gjatë studimit të mbasdites, individualisht. Dhe largohej për në shtëpinë e tij, kur ishte bindur se të gjithë e kishim përvetësuar programin.

Ashtu sikurse u largua atë ditë që u takuam rastësisht tek ai shatërvani i vjetër dhe fjalëve të mia se e nderonim edhe pse ishte aq i ditur, me shaka j'u përgjigj me fjalët e ëll Durantit: “Gjashtëdhjetë vjet më parë i dija të gjitha. Tani nuk di asgjë”. Jo o profesor yni i paharruar; ti mbete i ditur deri në fund të jetës, paçka se nuk more prej saj atë që meritoje. E di se Presidenti i Republikës është mjaft i vëmendshëm ndaj figurave të tilla, por duke qenë se i ati i tij ka qenë oficer dhe mësues në shkollën e lavdishme “Skënderbej” dhe duhet të ketë dëgjuar prej tij për vlerat e veçanta të modestit e madhështorisht Viron Cinxo, duhet t'i akordojë atij, të paktën titullin mëse të merituar “Mjeshtër i Madh”.

Ky do të ishte dhe një nder që i bëhet shoqatës tonë, që nderimin për njerëz si ai e ruajmë thellë brenda zemrës tonë. Ky vlerësim do të shërbejë njëkohësisht edhe si shembulli që duhet ndjekur nga mësuesit tanë sot, kur më shumë se kurrë, arsimi yni ka nevojë.

NATO-ja i dha fund një konflikti të tmerrshëm në Kosovë

(Vijon nga faqja 9)

sashi Ovada tha se shpallja e pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt të 2008, nuk e ka shkelur të drejtën ndërkombëtare, se pavarësia e Kosovës nuk e ka shkelur Rezolutën 1244 si dhe kornizën kushtetuese të UNMIK. Mirëpo, Serbia investon shumë që disa shtete të tërheqin vendimin e njohjes, dhe të bllokojë pranimin e Kosovës në organizatat ndërkombëtare. Kosova i është përgjigjur duke futur taksa të larta për mallrat nga Serbia, të cilat tani janë shfuqizuar në mënyrë që të ofroj mundësi për dialog me Serbinë për të gjetur zgjidhje që është e përshtatshme për të dy palët.

PREZENCA E NATO-S NË KOSOVË FAKTOR I SIGURISË NË RAJON

Dislokimi i trupave të NATO-s, 21 vjet më parë, nga populli i Kosovës cilësohet si ditë e veçantë, sepse gjithmonë sipas tyre, kujtohen emocionet që përjetonin derisa trupat e NATO-s hynin në Kosovë. NATO-ja me trupat e saj në Kosovë vazhdon misionin që mbetet i pandryshuar si faktor i domosdoshëm i stabilizimit për të ardhmen e Kosovës, për zhvillim ekonomik dhe për sigurinë rajonale. Por, në Serbi, edhe pas 21 viteve mungojnë informata për vërasjet dhe varret masive të shqiptarëve të pafajshëm. Ato janë të panjohura për opinionin e gjerë serb sepse një pjesë e mirë e tyre nuk

e dinë ose nuk dëshirojnë të dinë për këto krime. Gjatë gjithë kohës nga vitet kur në Kosovë u zbarkuan forcat e NATO-s e deri më sot, në Serbi ka mbizotëruar ligji i heshtjes, sipas të cilit, askush nuk thotë asgjë, dhe të gjithë e dinë gjithçka. Sikur të gjithë të flisnin hapur, atëherë do të tregonin se duke luftuar për idenë e Serbisë së Madhe, Serbia okupoi dhe u grindë pothuaj me të gjitha republikat dhe krahinat e ish Jugosllavisë.

Sikur opinioni serb do të artikulonte sinqerisht këto ngjarje, duke filluar nga udhëheqësit politik e deri te mediat, atëherë do të tregonin për dëbimet, vrasjet, përndjekjet politike, racore dhe fetare, për veprime ç'njerëzore, zhvendosjet me forcë, shfarosjet, torturat, burrqosjet e paligjshme, shkaktimet e vuajtjeve, përvetësimet e pronës, trajtimet mizore të civilëve shqiptarë, për plaçkitjet, shkatërrimet dhe dëmtimet e monumenteve historike, institucioneve arsimore, fetare... Sikur të kishte drejtës ata do të dënonin luftërat e turpshme të nacionalistëve të ushtrisë, policisë, paramilitarëve dhe forcave profashiste serbe. Dita e çlirimit të Kosovës do duhej të ishte ditë zie për Serbinë, ditë turpi dhe flamujt e tyre do duhej të ulet në gjysmë-shtizë. Ndaj, 12 qershori duhet të shërbejë si ditë kujtimi për viktimat, sakrificat e shumë brezave, si ditë mirënjohjeje ndaj NATO-s për ndihmën e saj për lirin e shqiptarëve dhe çlirimin e Kosovës, por të shërbejë edhe si obligim për ndërtimin e një shoqërie demokratike.

LIBRI

Çfarë shkruan autori, si hyrje e librit të tij “Vajza që sfidoi oficerin grek”?

QASJE REALE NË LIBRIN E QEMAL GEGOLLARIT

Nga Liljana Muça


“Rrëmbimi i vogëlushes Behare Sheme Myrto në fshatin Gjonbabas të Oparit, në fund të vitit 1914 nga majori grek Pandozollopus dhe çuarja e saj në Greqi e më pas në Amerikë me qëllim birësimi, përbënte një ngjarje të veçantë dhe të rrallë për atë kohë. Ngjarja për dekada të tëra u transmetua gojë më gojë, ku secili jepte versionet e veta sipas hamendësimeve, mbasi harku i gjatë kohor kishte bërë zbehje të kujtesës.

Kjo ngjarje mua më ngacmoi dhe duke dashur të di të vërtetën reale, fillova të studioj gazetën “Dielli” të atyre viteve, e cila botohej në Boston të Amerikës, rreth viteve 1917-1918. Nga të gjitha materialet që gjeta në këtë gazetë dola në përfundimin se me ato mund të realizohej një libër i plotë për atë ngjarje interesante dhe të pazakontë për atë kohë.

Meqë unë isha botues i gazetës “Opari”, disa prej këtyre materialeve i botova në këtë gazetë. Pra si rezultat i një pune të përkushtuar e me vullnet të mire, në vitin 2009 hartova librin. Por në këtë kohë për arsye shëndetësore nuk munda ta botoja librin, i cili mbeti dorëshkrim.

Në libër ngjarjet janë shkruar, të bazuar në materiale konkrete, duke pasqyruar më së shumti një kronikë historike të asaj kohe. Së fundmi doja të sqaroja se këtë rrëfim interesant e filloj me disa rreshta për krahinën e Oparit dhe banorët e saj në vitin 1914 që lidhët me këtë ngjarje, në të cilën andartët grekë në kuadrin e luftës për Vorio-Epirin, kryen në krahinën e Oparit maskara nga më ç'njerëzoret, deri në aktin e dhimbshëm të rrëmbimit të vogëlueshes Behare Sheme Myrta nga xhelati i titulluar oficer e me graden e majorit, Pandozolopus.


Duke u njohur lexuesi, sidomos lexuesi i ri, me kushtet politike, ekonomike dhe sociale të atyre viteve, në të cilat zhvillohen ngjarjet në krahinën e



Oparit, do jetë më në gjëndje për të nxjerrë përfundime të sakta”.

NJË KRONIKË REALE DHE SH TJELLIM ARTISTIK NË KONTEKSTIN HISTORIK

Si në shumë libra të tjerë, objekt i krijimtarisë



së Qemal Gegollarit ka qënë krahina e Oparit me një modelim vlerash, të trimërisë, besës, bujarisë, dhe humanizmit të cilat më së miri shpalosen në këtë libër të titulluar “Vajza që sfidoi oficerin grek”. Qemali e ka ndjerë si një obligim moral për të marrë penën që të tregojë rrëmbimin e një minoreneje katër vjeçare të quajtur Behare Sheme Myrta. Subjekti i librit jepet përmes një shtjellimi të thjeshtë linear, i cili nis me rrëmbimin e vajzës së vogël nga oficeri grek Pandozollopus dhe përpjekjet e tij të jashtëligjshme për ta birësuar në Greqi, Itali dhe deri në Amerikë, por që askund nuk munda, sepse asnjë “argument” nuk i bindi autoritetet se gjoja vajzën ia kishin dhuruar me dëshirë prindërit e varfër.

Në kompleksitetin e tij libri ka pak nga gjitha; histori, atdhetari patriarkalizëm, ekonomi dhe përshkrime artistike të dekorit të fshatit Gjonbabas ku është vendosur familja e SHEME MYRTOS. Hapësira ku veprojnë personazhet e librit është treva e Oparit në tërësi, por dinamika e jetës i zhvendos trimat atdhetarë oparakë deri në Amerikën e largët, në kërkim të vajzës së tyre, rrëmbyer forcësisht nga oficeri grek. Pika kulmore e kësaj kronike reale është kur gjykatorkja e qytetit të Ëançesterit dha vendimin në favor tashmë të adoleshentes Behare SHEME MYRTA e cila u mbajt pa asnjë të drejtë ligjore nga oficeri grek. Në gjithë këtë të kalvar spikat vendosmëria e emigrantëve oparakë në Amerikë si; një Shoqatë Bamirësie e kryesuar nga Leon Katro, kryetari i shoqatës nr 46 “Vatra” Feko Tudasi në Besebe-Arizona, të cilët në bashkëveprim me kryetarin e përgjithshëm të shoqatës “Vatra” Fan Noli në Amerikë bënë të mundur rimarrjen dhe riatdhesimin e Behares.

Ja se si shkruan Fan. Noli në ditarin e tij:

TË DIELËN, më 15 Korrik

“Në orën 3 P.M. konferencë në Inglisht për Kryqin e Kuq në ëançester. Në 5 P.M. Vajtëm të shohim vajzën Behare Sheme Myrto në shtëpinë e grekut Pandozollopous. Mbete në ëançester atë natë për këtë punë.” ((Nasho Jorgaqi)

Në përfundim të këtij shkrimi duhet theksuar se libri përshkohet me detaje tepër emocionuese në zhvillim të ngjarjeve për fatin e minorenes nga Gjonbaba-si. Të marrësh përsipër hartimin e një kronike të tillë reale do zotësi dhe përgjegjshmëri, të cilat Q. Gegollarit i kanë buruar së brëndëshmi nga shpirti i tij vizionar e fisnik, me një punë hulmutonjëse për t'u admiruar, plot njëzet e katër referenca të shtypit të kohës. Ashtu si edhe në libra të tjerë të shkruar prej tij për krahinën e Oparit, le të mbetet në memorie një nga ata penëshkrues që lë gjurmë të pashlyeshme.

Mirënjohe OBVL-së dhe gazetës “VETERANI”

Nga Zaim SEFA

Prej tre vitesh që bashkëpunoj me gazetën “VET-ERANI” kam arritur në konkluzionin se kjo gazetë është një konkurrese e denjë në tregun mediatik shqiptar.

Larmia e rubrikave e tematikave dhe hapja ndaj



lexuesve e opinionistëve ia ka rritur vlerat kësaj gazete. Botimi i saj, e printuar dhe në internet u ka krijuar shansin që të njihen me të, të shkruajnë e të botojnë artikujt e tyre, jo vetëm veteranëve e pasardhësve por çdo njërit që dëshiron të njohë e propogandojë vlerat e Luftës së lavdishme Anti-fashiste Nacionalçlirimtare.

Kështu “Veterani” është bërë gazetë e edukimit patriotik të brezave, si përçuese e historisë së lavdishme të popullit tonë në shekuj.

Para tre vitesh e solla me mëdyshje një artikull për patriotët e zonës time, Arrnit të Kukësit, por kur ai pa dritën e botimit në numrin e radhës, me dhjetra bashkëfshatarë më uruan, çka do të thotë se ata e kishin marrë dhe lexuar gazetën “VETERANI”.

Unë gjej rastin të falenderoj kryeredaktorin e gazetës z.Halil Rama dhe zëvendëskryeredaktorin z.Sakip Cami, dy publicistë e shkrimtarë të njohur që me seriozitetin e përkushtimit e tyre e kanë rritur në vazhdimësi cilësinë e "VETERANI"-it.

Me këtë rast ftoj anëtarët e organizatës së Bashkusur të Veteranëve të LANÇ të popullit shqiptar që të ndihmojnë këtë gazetë me artikujt e tyre për probleme të ndryshme.

Mirënjohje të veçantë i shpreh kryetari të OB-VL-së, kolonel Myfit Guxhollit dhe gjithë kryesisë së kësaj organizate për rolin që kanë luajtur dhe luajnë në mbrojtje të vlerave më të mira atdhetare të popullit tonë.

FOTOREPORTAZH

Dekorimi i kol.Myfit Guxhollit në presidencë

